



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



**Raporti
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin janar 2020**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në vijim të komunikimit me ju, në rolin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me qëllim përditësimin tuaj mbi punën e bërë gjatë këtij muaji, lejomëni të ndaj me ju raportin e muajit janar 2020 si dhe trajtimin e ankesave në kuadër të njoftimeve periodike.

Në kuadër të transformimit rrënjësor të ofrimit të shërbimeve në rrugë elektronike, përmes portalit e-albania.al, në fillim të muajit janar u bë i mundur aplikimi online për 472 shërbime për qytetarët dhe bizneset, duke shmangur kështu rradhët nëpër sportele. Ky proces do të vijojë përgjatë vitit ku deri në fund të tij, rreth 90% e të gjitha aplikimeve për shërbime, do të bëhen online.

Në vijimësi të Samitit Rajonal të Turizmit të mbajtur në Tiranë, zhvilluam një takim dypalësh me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik dhe Teknologjisë të Sllovenisë, ku patëm mundësinë të diskutonim mbi marrëdhënien ekonomike mes dy vendeve, sektorët prioritarë me interes të përbashkët dhe rritjen e mëtejshme të shkëmbimeve tregtare.

Samiti i Grave të Biznesit të Diasporës bëri bashkë gra sipërmarrëse, përfaqësues të Qeverisë dhe institucioneve të ndryshme, në një diskutim mbi sfidat për fuqizim dhe përfshirje më të madhe të grave dhe vajzave në biznes dhe sektorë të tjerë, si një komponent i rëndësishëm i rritjes ekonomike.

Zhvilluam takime periodike me koordinatorët e biznesit në ministri dhe institucione varësie për të analizuar ankesat që vijnë nga sipërmarrësit por edhe për të përmirësuar më tej sistemin e gjurmueshmërisë së tyre.

Këtë muaj mori interes të vecantë hapja e ankandit për ndërtimin e një parku fotovoltaik me kapacitet të instaluar 140 MW në zonën e Karavastasë, një procedurë kjo e cila ka marrë vemëndje nga investitorët e interesuar për pjesëmarrje në të.

Asambleja e Përgjithshme e Confindustria Albania gjeneroi diskutime të frytshme mbi klimën e investimeve dhe zhvillimin e mëtejshëm të marrëshënieve Shqipëri-Itali, ku gjithashtu u prezantua edhe dokumenti “Guida Paese 2020” një guidë kjo mjaft e pasur që përfshin kontekstin politik, ekonominë, të dhëna mbi legjisllacionin tatimor e doganor si dhe shumë informacione të tjera për investitorët e huaj.

Në Techspace u mbajt konkursi i kodimit ku të rinjtë e talentuar dhe inovativë patën mundësinë të prezantojnë aplikacione të ndryshme të lidhura me fushën e monitorimit të çmimit të tregut për produktet bujqësore dhe zhvillimin e aplikacioneve që mund t’u vijjnë në ndihmë personave të moshuar.

Në mbledhjen e rradhës së Këshillit të Investimeve u diskutua mbi ndërvëprimin e biznesit me pushtetin vendor, zhvillimin ekonomik të qyteteve, mirëadministrimin fiskal dhe nxitjen e komunikimit midis sipërmarrësve dhe institucioneve.

Rishikimi i ligjit “Për Prokurimet Publike” solli nevojën e diskutimit të tij në një tryezë të përbashkët mes përfaqësuesve të Autoritetit të Prokurimeve Publike dhe përfaqësuesve të dhomave të tregtisë dhe industrisë në vend, me qëllim paraqitjen e eksperiencave, problematikave dhe propozimeve, që do të cojnë së shpejti në një përmirësim të këtij ligji.

Duke shpresuar në vijimin e komunikimit me ju, shpreh bindjen time të thellë se nëpërmjet bashkëpunimit ne mund të përmirësojmë klimën e të bërit biznes në vendin tonë.


Me konsideratën më të lartë,

Eduard Shalsi


Analiza e Ankesave Janar 2020

Gjithashtu, në kuadër të ndryshimit të formatit të raportimit dhe të krijimit të rrjetit të koordinatorëve, dëshirojmë t'ju paraqesim disa grafikë në lidhje me ankesat për muajin janar që vijojnë si më poshtë.


1. Shpërndarja e ankesave në baza javore



2. Statusi i ankesave dhe trajtimi i tyre



3. Statusi dhe shpërndarja e ankesave sipas ministrive dhe bashkive



4. Statusi dhe shpërndarja e ankesave sipas ministrive dhe institucioneve të varësisë dhe bashkive sipas qarkut

